

ALBANIAN POST

**Nr.
73**

**SHTATOR /
SEPTEMBER
2024**

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



06 Aqif Neli...



12-13 Emine S. Hoti...



17 Have Cufaj...



07 Ibrahim Ağcagül...

I NUMËRUARI I GUSHTIT TË FUNDIT

Para pak ditësh u largua i numëruari i fundit i Gushtit të Fundit. Iu duk se ishte me fat, që po filmohej përherë të parë, spse tashmë numri i tij po mbyllte një numërim zyrtar. Dhe pas tij, thuhej se do të shfaqej numërimi i tij në një film, jo si tek "Dimri i Fundit" me frikë (Gjermani e priste në Gjermani), pasi në skenar, thuhej se do të vazhdoj akoma më shumë numërimi tek sezioni i madh vjeshtor disamilionësh turistik. Ndaj ai u ndje mirë kur e dëgjoi në korr ky ishte disamilionëshi historik i turizmit veror!

E ai u ndje disi i emocionuar, në fakt, kur pa se edhe ai me këtë numërim kishte bërë padashje pakt. Edhe pse ishte shqiptar, dhe pse kishte ardhur të shihte të afërmit e tij në shtëpinë e tij për pak ditë në lista quhej turist! Ky turist shqiptar, e ndjente veten ndryshe për herë të parë. Kishte hyrë krejt pa menduar e papritur në këtë numërim filmik, në këtë listë meritore, jo më nga veprat, por nga xhepat. Heshti një çast dhe nisi të zbërthente ato që kishte dëgjuar

e që po dëgjonte...

Për xhepat e e shqiptarëve, që jetojnë, punojnë dhe aktivizohen jashtë Shqipërisë, dhe që erdhën dhe vizituan Shqipërinë askush nuk pyet. Për Ministrinë e Turizmit kthimi i tyre i përkohshëm është statistikë. Për pikat doganore e në kalimet e tjera më tutje është vetëm mburrje. Për zyrat në shtet ardhja e tyre është festë. Për bashkitë në mos më pak është arkë. Për tregjet në rrugë e në sokak është bankë. Për supermarketet është sikurse me të tjerët, tek çmimet dhe standartet. Për dyqanet ku këmbehen valutat është ngjashëm me batutat (e pyeti shoku-shokun, teksa dilet nga një Këmbimore në Shkodër, pse qesh: Eh, more vëlla dola rru' e qeth(!?)). E për të tjera edhe sikur ti them askush nuk ngre më...

(vijon në faqen 02)

FLORA'S GUSTO ITALIAN

RESTORANT I VLERËSUAR PËR HIGJENË

Lexo:
FAQE 3 DHE 5

Restorant cilësor

Kualitet dhe pastërti shembullore

Cilësi dhe kulturë profesionale

Flora Kolaveri Osmani
DREJTORE E FLORA'S GUSTO ITALIAN

MIRË SE VINI !

Tu mirëpresim duke urruar se keni kaluar pushime të mbara

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi i shqiptarëve në Kilburn High Road. Aty ku nën drejtimin e biznesmenit Mahmut Siringul do të gjeni të gjithë produktet e cilësisë lartë dhe me çmime konkurruese.

KUALITET - CILËSI

02073721059 info@hilalfood.co.uk 322-324 Kilburn High Road, NW6 2QN

MIRË SE VINI!

WWW.FJALAEIRE.COM

(vijon nga faqja 01)

... ndonjë problem.

Ata vijnë dhe fjalorët e xhepit nisin e shpërthejnë sipas rastit. Bilbilat e policisë i quajnë "drejtues të pakualifikuar", kafenetë "vizitorë të vonuar", e në raste të tjera në fakt, mbesin gojërat tek nofka "emigrant". Kudo dëgjohej përkitazi, erdhën emigrantët, do rrinë këtë muaj dhe do ikin: "Miku im, mikja ime kujdes çmimin! Çmimin... E gjizës, kujdes, mos e shit nën... Emigrantët duan specia me gjizë. Ata duan..." Dhe gjiza u tretet në bark. E kanë hak! Hak brenda kësaj matrice, brenda kësaj ane arithmetike, ku nuk bën askush sy, qoftë dhe një nga ata ligjorët e syrtareve, që shkon të kontrolloj fjalorin tek emri çmime.

Çmimet kanë bërë udhë të gjatë në xhepin dhe kursimet

e tyre. Biletat janë sikurse ndodh me raketat. Ngrihen nga toka dhe plasën duke zhurmuar në ajër. Çmime marramendëse udhëtimesh. Çmime marramendëse kostosh.. Gjithkush e nis me një faturë të padjegur dritash, me një ujë të papirë, me një taksë bashkie për pastrimin që kurë se ka bërë pis, me një mistri në dorë për suvanë e rënë gjatë dimrit, me një shuk para për hidraulikun, që e lut dhe nuk e gjen më kafeneve, e ... pastaj në fund me veten. Me veten se ka ardhur, pra ka mbërritur emigranti për pushime...

Pushime të mbara, me një risi të re, i numëruar si tek "Dimri i Fundit" në rrëmujën turistike të Pyllit të Ri të xhirimeve propagandistike. Dhe ku do të vësh pikën? Ku ta gjesh të plagosurin me kusurin e xhepit? Tek shazlloni? Kush më

thotë sa ju kushtoi?! Tek veza surbull, apo ajo e ... Eh, kush e bëri vezën, e kush pulën, pula-vezë e veza pulë, seç u trash kjo formulë. E kënga e pupullit shkon larg në fakt. Aty ka muzikë dhe përditë pa frikë. E kush mund ta quaj ndotjen akustike ndonjë problem për veshët e lodhura e të dyllosura të emigrantëve?

Për larushinë që sjell gushti, sidomos në Shqipëri, është një muaj që po hyn në histori. Shpëtimtari i arkës së shtetit, dhe i xhepit të miletit, tashmë pa frikë quhet muaji gusht që të gjitha ardhjet, prurjet dhe tkurrjet i mbledh me një grusht. Në një grusht të tillë e vërteta është se gjithçka zë fill. E fill nuk është më trill. Është thirrje publike: Mirësevini në Shqipërinë turistike! Por është edhe një kujtesë, ndoshta në kthimin emigrant me vonesë:

I dashur votues kësaj radhe kujdes "votën" tënde virtuale, mos harro dhe patjetër të na urdhërosh edhe në vitin tjetër. Kështu ky lloj emigranti, mes vapës që i ngjan prushit, duket se në sytë e sotme të shqipërisë zyrtare është i numëruari i Gushtit të Fundit. Themi kështu, se në vitin tjetër do të jenë edhe zgjedhjet e përgjithshme, dhe një përlogaritme tjetër ndoshta do të jetë më e bindshme. Më e bindshme, apo akoma më e frikshme?! Gjithkush kur ti lexoj këto fjali, do të thotë ne i dimë të gjitha. Po fundja tani kemi shtet të rilindur, kemi dhe një ise aty nga "Mjaft", dhe prandaj zyrtarisht pasgushtin e përcjelljes dhe shtatorin e vjeljes e nisëm aritmetikisht nga dyert e mbyllura në Dajt. Ndaj i dashur emigrant, pos rrjedhës, kujdes votën virtuale të 2025-ës!

SI TË RUAJMË FARËN E VJETËR

Këto domate që shikoni janë prodhuar në Londër. Janë prodhuar nga shqiptarë që kanë marë në përdorim kopshte që jepen me ligjin përkatës nga bashkitë. Dhe ndërsa janë domate që na kujtojnë farën e dikurshme, të cilat zor se i gjen dhe në vendlindje, sot ka rëndësi mbajtja gjallë e farave të tyre. Një nga prodhuesit e tyre në Londër, jep shpjegimet përkatëse:

Nëse jeni një nga kopshtarët që vendosin mënjanë farat për sezonin e ardhshëm nga prodhimi i tyre, jeni të vetëdijshëm për të paktën një nga problemet - sa kohë dhe si mund t'i ruajmë ato. Kjo vlen më së shumti për ato në të cilat nuk këshillohet të mbillen vitin e ardhshëm, por është mirë të presim me përdorimin e tyre. Deri këtu mirë, por duhet t'i mbajmë në një vend të ndryshëm nga ato të përgatitura për mbjellje këtë vit për të mos i ngatërruar. Por ndonjëherë mbishkrimet

në to humbasin dhe për disa thjesht harrojmë se ku i kemi lënë: një mendje - është për

vitesh të hasim fara që duket se nuk kanë më asnjë mundësi për të mbirë.

edhe farat shumë të vjetra të specave të "ringjallen" pas vitesh ruajtje. Në një tenxhere hedhim ujin e rubinetit pothuajse deri në majë, vendosim kapakun dhe e vendosim në sobë, duke pritur që lëngu të ngrohet deri në 90 gradë Celsius. Ky moment quhet "çelës i bardhë" - fluskat e ajrit fillojnë të shfaqen në sipërfaqen e ujit, por ai ende nuk ka filluar të vlojë. Më pas vjen faza më e vështirë: tenxherja duhet të hiqet sa më shpejt nga zjarri pa hequr kapakun dhe të ftohet shpejt me një rrjedhë uji të rrjedhshëm, të cilin duhet të kemi kujdes që të mos bjerë në tenxhere.

Pra, ne kemi marrë tashmë një lëng mrekullie. Mund të ruhet për një kohë të gjatë. Është mirë që ta derdhni në një shishe plastike deri në majë, në mënyrë që të mos mbetet ajër. Farat e vjetra zhyten në këtë ujë, palosen në një peshqir, lihen në një vend të ngrohtë dhe presim që të na kënaqin me filiza.



dimër apo verë, thonë të moshuarit. Dhe ndodh që pas

Megjithatë, ja një mënyrë e provuar për të bërë që

FLORA'S




Gusto Italian



Flora's Gusto Italian



I
VLERËSUAR
PËR
HIGJENË



Restoranti i munguar modern i shqiptarëve

02089047775

DY MINUTA NGA UNDERGROUNDI PRESTON ROAD

“FLORA’S GUSTO ITALIAN” ËSHTË TASHMË NJË MODEL DHE NJË SIMBOL INTEGRIMI

Pronarja e drejtuesja e “Flora’s Gusto Italian” Flora Osmani thotë se “Pas vitesh punë të palodhur, hapa restorantin “Flora’s Gusto Italian” dhe shumë shpejt u bë një sukses me paraqitje të shumta që pasuan në media. Më kanë pyetur shpesh për vendin e grave në botën e kuzhinës dhe çfarë mund t’i pengojë gratë. Mendoj se mungesa e përfaqësimit të grave në mediat ushqimore, veçanërisht mungesa e grave të përfshira në listat e industrisë së shefave të kuzhinës “më me ndikim”

ose “më të fuqishëm” dërgojnë mesazhe të fuqishme.”

Më tej ajo thekson se duke u rritur në vitet më të rëndësishme të jetës sime me një nënë që ishte një kuzhinierë e jashtëzakonshme në shtëpi dhe një baba që i pëlqente të na këshillonte mjaft mirë, më pas me një bashkëshort mjaft punëtor dhe shumë i dhënë mbas ushqimit cilësor unë dhe



Mungesa jonë e plotë e së shkuarës, mbështetja tek ndjesia e traditës është në fakt mjaft çliruese, frymëzimi mund të godasë një ditë dhe të veprohet në tjetrën. Dhe nëse klientët e pëlqejnë, ajo qëndron. Çdo pjesë e asaj që

njerëzit e mi ramë në dashuri me ushqimin e mirë, pak e dija se kjo do të më ndihmonte të më jepte përparësi kur të dilja në këtë front, që tashmë e drejtoj me pasionin më të madh.

Karriera ime sot kombinon dy nga pasionet e mia të mëdha, respektimin me cilësi të lartë me kualitetin dhe disiplinën në angazhim. Unë jam tashmë gruaja që kam thyer disa mite, dhe që jam tashmë vetvetja, dhe gjatë kohe kam ndjerrë më shumë se kurë atë që mund të bëjë një grua pasionante, një grua e zonja dhe e përkushtuar, kur ka gjithnjë pranë një familje shembullore që e mbështet shumë.

Vite më parë mendova se jeta ime ishte harruar. Më vonë do të ngazhohesha në mjaft drejtime. Do të bëhesha një grua që do të jepte dhe një kontribut në komunitet, dhe më gjerë në Londër. Ky mjedis macho më la në buzë me ankthin dhe depresionin tim të së shkuarës, tani kam gëzimin më të madh, kam familjen, kam “Flora’s Gusto Italian” dhe stafin emrekullueshëm.

bëjmë është e frymëzuar nga cilësitë femërore të kujdesit dhe edukimit dhe nuk do të jetë çudi që përbërësit e mirë janë një pjesë kyçe e etikës sime; miell organik, bulmet, fruta dhe perime të furnizuara në vend – aq vendas sa që ekziston edhe një sistem shkëmbimi me kopshtarët lokalë dhe mbajtësit e alotmenteve.

Jam vërtet krenare për ekipin tim që vazhduam të mbanim gjallë një emër në këtë lartësi, duke ushqyer komunitetin, duke u dhënë atyre në nevojë dhe duke u dhënë pako ushqimore për familjet e uritura me fëmijë.

“Flora’s Gusto Italian” është tashmë një model dhe një simbol integrimi në rritje. Kjo falë zonjës së nderuar Flora Osmani, që di si të sillet dhe si të ndërtojë një biznes të nivelit të kërkuar. Dhe kështu po e rithem se karriera ime sot kombinon dy nga pasionet e mia të mëdha, të qenit një nënë shembullore me fëmijë të edukuar dhe një biznesmene me një restorant të mirëfilltë e tejet të kërkuar e frekuentuar.





Supermarketi jonë është një vend i përsosur për të gjetur ushqimin tuaj të preferuar shqiptar! Ne përdorim vetëm burimet konkurruese për të siguruar cilësinë e shportës sonë.



Oferta speciale dhe çmime konkurruese

MERRENI PRODUKTIN SHQIPTAR ORIGINAL!



151-155 BALLARDS LN, CHURCH
END, LONDON N3 1LJ

PËRTEJ NJË URIMI PËR INTELEKTUALIN AQIF NELI

Thonë se në emigrim njihen më së shumti njerëzit. Dhe vetë emigrimi është një risi më vete në këtë pikë. Emigrimi ka kontribuar në pasurimin e diversitetit të kulturave, etnive dhe racave në vendet e zhvilluara, por dhe ka dhënë shembuj të ndryshëm personal dhe vyrti. Individët që migrojnë përjetojnë stresa të shumta që mund të ndikojnë në mirëqenien e tyre mendore, duke përfshirë humbjen e normave kulturore, zakoneve fetare dhe sistemeve të mbështetjes sociale, përshtatjen me një kulturë të re dhe ndryshime në identitetin dhe konceptin e vetvetes.

Ndërveprimi kompleks i procesit të migrimit, humbjes kulturore, identitetit kulturor dhe kongruitetit kulturor, së bashku me faktorët biologjikë, psikologjikë dhe socialë, hipotezohet se luajnë një rol të madh. Dhe kështu modelët janë të shumta. I sotmi është shqiptari Aqif Neli, intelektual dhe biznesmeni i suksesshëm shqiptar në BM, që feston 58 vjetorin e ditëlindjes. Ai vërtet plotëson atë që është thënë, thuhet dhe do të mbetet se më së shumti njerëzit e mirë, intelektualët, patriotët, humanistët dhe familjarët njohën në emigrim. Ai është mik dhe fisnik i mjaft njerëzve dhe dhe anëtarëve të komuniteteve të ndryshme. Përtej urimit meritore për ditëlindjen e tij po ripërcjellim për lexuesit tanë vlerat në rritje të tij...

Intelektuali dhe biznesmeni i suksesshëm shqiptar Aqif Neli është prej kohësh një nga modelët e referimit të suksesit dhe integritetit për shqiptarët në MB. Ai dallohet për kontributin e shquar dhënë në fushën e humanizmit ndaj komuniteti

shqiptar dhe njerëzve në përgjithësi, sponsorizimin e



aktiviteteve dhe ndihmën për Shkollat shqip në Mbretëri të Bashkuar dhe për ngritjen e vazhdueshme të figurës shqiptare në mjedisin britanik. Ai është dalluar dhe nderuar gjithnjë nga institucionet britanike përkatëse për punën dhe rezultatet e larta me kompaninë e tij "AN Construction Solution Limited". Ai gjithnjë është gjithnjë në mesin e të punësuarve të shumtë të tij shqiptarë e të huaj, në mesin e fronteve të reja të punës. Biznemsnein e dalluar shqiptar Aqif Neli e gjen gjithnjë në krye të një paneli, ku ai ka pikënisjen parësore të punës me tre elementët kryesorë e të domosdoshëm të një sukse: Shëndeti dhe siguria, Produkti dhe Cilësia. Gjithashtu Aqif Neli dallohet dhe për kontributin e tij të vazhdueshëm në ndihmë të integritetit të komunitetit shqiptar në Britaninë e Madhe, duke qenë Kryetar i Bordit të shoqatës shqiptare "Mother Tereza – Albanian Union".

Aqif Neli, intelektual dhe biznesmeni i kualifikuar i fushës së ndërtimit, në jo

pak raste ka merituar fjalët dhe respektin më të lartë komunitar dhe britanik në fushën ku ai tashmë operon me kompaninë e tij prej vitesh. Në një ambient pune ku diskursi i gjërave rrek estetikën e të gjithë panoramës dhe me një modesti të shtjellët respekti kupton se njeriu i suksesshëm mësohet nga udhëtimi i tij, jo nga destinacioni. Mësojmë se si arriti atje, pikërisht në majën e suksesit, duke kuptuar se sa vështirësi i është dashur të kalojë e kapërcejë me durim e përkushtim për të arritur ku është sot me një stendë që flet vetëm për certifikata, vlerësime, dedikime dhe mbi të gjitha për rezultate

e cilësi. Në këtë kontekst gjithkush ndjehet krenar dhe mëson mëson mes arritjeve dhe vlerësimeve se çfarë bëjnë njerëzit e suksesshëm si intelektual i plotësuar Aqif Neli. Për Aqif Nelin është jeta që nis larg në Atdhe me bukuritë e memorjet mes shtatë fëmijëve vëllezër e motra të një familjeje me gene patriotike dhe disiplinore atdhedashëse, ku u rrit vetë protagonistin, që babai i tij Nel dhe nëna i rritën të mbeten modele për të gjithë. Aty, atij i kujtohen mjaft gjëra që ushqyen vizionin e tij që në fëmijëri, kur babai i thoshte të shihte më së miri udhën e vet. I kujtohen të gjitha dhe në disa raste edhe përlohet. E ndjen se ende ka për të shkruar më tej mes këshillave të vlefshme familjare. E ndjen se ai tashmë duhet të shkojë në atë që ka mbajtur në zemër e në mendje. Rezultatet nisin qëkur dhjetat e shoqëronin përditë në shkollën e vendlindjes dhe më pas e ngritën deri në nivele të larta specializimesh. Studenti i shkëlqyer, kandidati për pedagog në një nga universitetet më prestigjioze

të kohës, i mirëspecializuar në një vend mik të NATO's ndoshta dhe deri tek niveli më i lartë i kualifikimit Degree në fushën e konstruksionit në Britani të Madhe etj. Duke shkruar më tej të gjitha që janë në dosjet e vlerësimeve të kompanisë, janë faktor dhe rezultat i gjatë dhe i ndjeshëm. Pasionant, nuk është vetëm një pjesë që e shtyn tek suksezi biznesmenin Aqif Neli. Janë shumë arsye që nisin nga elementi më i thjeshtë, njeriu intelektual i specializuar në personel, rezultatet e larta, puna si manaxher, kontraktor, disa nga pasionet që e kanë shtyrë në jetë jo vetëm që të jetë i suksesshëm, por dhe një model komunitar. Kur flasin për punën ose jetën e tij, fytyra e tij ndizet dhe na tregon se ai vetë nuk mund të flasë për veten, por për pasionet e tij. Ai është si të gjithë ata që e duan atë që bëjnë. Ata kanë një sens të fortë të përkatësisë në punën e tyre, familjeve të tyre në çdo sferë të jetës. Ndaj dhe kanë edhe familje model. Në rastin konkret një dashuri e largët bashkëshortore dhe një familje me dy fëmijë të talentuar dhe model në jetën e tyre. Bashkëshortja e tij, doktoreshë Vali, natyrisht është një pjesë e suksesit që bashkohet përtej pasionit të kësaj familjeje të nderuar komunitare.

Ai e nisi me punën, përkushtimin, gjuhën angleze dhe më tej me marrjen e një qëndrimi pozitiv për suksesin e sotëm të "AN Construction Solution Limited", si një kompani model dhe mjaft e vlerësuar. Më parë ishin pedagogët e tij në Atdhe dhe këtu në BM që shihnin tek ai pozitivitetin mbi të cilin edhe e vlerësonin dhe e propozonin më lart. Integriteti, ëshë themeli ku "AN Construction Solution Limited" ka një nga atributet më të vlerësuara të një personi të suksesshëm.

RRETH PIKËTAKIMEVE TË FJALËS SË URTË

Dhe kjo kur pikëtakohet si në një bisedë me zotin Ibrahim Ağcagül, babai i pronarit të Dicle në Finchley Road, zotin Ali, dhe një biznesmen me emër në kohë të ndryshme, natyrisht na jep shumë gjëra të mirëfillta dhe në kohë reale. Ai na flet me respekt për kushërinin e tij të nderuar, biznesmenin Mahmud Şiringul. Dhe naflet me urtësi të fjalës së urtë. Ja pse? Gjithkush udhëton. Udhëton dhe lëviz pa e kuptuar në përditësi. Ndërsa memorjet bashkë me të, sidomos ato që lidhen me fjalën, këshillën, urtësinë, udhëtojnë dhe lëvizin si në kohë, dhe në hapësirë. Dhe kështu pikëtakohen në kultura të ndryshme, flasin, komunikojnë, mendojnë, shkojnë në tëshkuarën, mbesin në të tashmen dhe synojnë në të ardhmen. Kjo lidhet dhe me ëndrrat, lidhet dhe me nënndërgjegjen. Kështu askush nuk mund të shpjegojë nënndërgjegjen. A janë të koduara në thelbin tonë këto fantazi dhe aspirata të ndrydhura drejt mundësive të parealizuara? A është lodhje nga rutina e së tashmes? Dhe ndoshta kujtime të huaja, të akumuluar gjenetikiisht në kujtesën tonë nga paraardhësit tanë të dashur e të shtrenjtë? Çfarë na thonë ëndrrat në imazhet dhe vendet që supozohet se jetojnë në

realitet, por që zbulohen në një ndryshim magjik, në ngjyra surreale, në një realitet të ndritshëm, surreal? Dhe ndërsa ëndrrat janë ato që na bëjnë të ndihemi ndryshe, ecja dhe pikëtakimi jonë në fjalë, urti dhe në mesazh, gjatë një takimi na bën të nënkuptojmë shumë e mjaft gjëra që vijnë nga e shkuara e na pikëtakojnë në të tashmen. Unë eci përgjatë një morie sendesh, produktesh, ushqimesh që vijnë në Dicle edhe nga Kosova e Shqipëria dhe gjuha jonë shkon në thelbin e bisedës. Në të majtë është një mbushje e madhe me produkte të mirëfillta nga Shqipëria, ku dallon edhe reçeli i ftoit, një reçel që natyrisht në shekuj bashkon të dy kulturat, turke dhe shqiptare, ku natyrisht dhe komuniteti kurd i ka në zemër. Një përvojë e shijshme dhe natyrale e shijes, sot, reçeli, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për blerësit online, gustatorët, entuziastët e ushqimeve natyrale dhe entuziastët e mëngjesit, është një shije e domosdoshme e tryezave tona. Reçeli është një produkt ushqimor i trashë dhe i ëmbël që përftohet nga kombinimi dhe zierja e frutave, sheqerit dhe ujit. Edhe pse zakonisht konsumohet për mëngjes, mund të përdoret edhe në ëmbëlsira dhe gatime të tjera.

Reçeli prodhohet me një metodë që lejon ruajtjen e tulit të frutave dhe ruajtjen afatgjatë. Reçeli prodhohet dhe konsumohet në mënyra të ngjashme në shumë kultura në mbarë botën. Këtu janë disa kultura të shquara reçeli. Francezët marrin një konsistencë natyrale duke përdorur fruta, sheqer dhe lëng limoni në përgatitjen e reçelit. Reçelrat e frutave të kuq janë veçanërisht të njohura. Britanikët i kushtojnë vëmendje raportit të frutave dhe sheqerit në prodhimin e reçelit. Reçelrat angleze në përgjithësi kanë një aromë më intensive dhe frutash. Prodhimi i reçelit në Turqi ofron një larmi dhe gamë të pasur shijesh. Reçeli i bërë me përbërës të ndryshëm dhe origjinalë si trëndafili, kungulli dhe ftua janë një pjesë e rëndësishme e mëngjesit turke. Prodhimi i reçelit në Amerikë është veçanërisht intensiv në rajonet veriore. Reçelrat amerikane theksojnë një ekuilibër të frutave dhe sheqerit dhe në përgjithësi janë të trasha dhe viskoze. Italianët i kushtojnë rëndësi përdorimit të frutave natyrale dhe të freskëta në prodhimin e reçelit. Reçelrat italiane përmbajnë relativisht më pak sheqer dhe njihen për teksturën e tyre ku bien në sy shijet e frutave.

Ndaj në këtë pikë thajse të gjithë kulturat pikëtakohen dhe flasin në një gjuhë, sikurse dhe tradita shqiptare gatimit të tij që vjen deri këtu tek Dicle i zotit Ali Ağcagül, që është bërë një qendër për shqiptarët e Finchley Central e më gjerë. E në këtë bisedë natyrisht fjala shkon tek fjala me zotin Ibrahim, që flet me dashamirësi për traditën dhe kulturën shqiptare dhe që në fakt ka vite që ka bashkëpunuar me shqiptarët e Kosovës në kohë të ndryshme të tregëtisë që ai ka zhvilluar. E kështu ai thotë se sot vëllezërit janë të lidhur më së shumti me xhepin dhe paranë dhe kanë humbur arsyen e një lidhjeje të madhe dhe tradicionale që ka ekzistuar me ta. Ndërsa bisedoj në anën e rrugës kryesore ndjej makinat



të lëvizin me shpejtësi përgjatë rrugës, turistët me kamera matin veten, kafenetë që janë dhe pronë e shqiptarëve në këtë zonë gumëzhijnë. Dhe është e ndritshme, përjetësia e verës, nxehtësia dhe kaosi i pushimeve, ashtu sikurse dhe përgatitja dhe rikthimi i tyre flasin për një angazhim serioz, që shihet tek menaxherja e Dicle Supermarket, Suna, dhe stafi tjetër i këtij supermarketi që sot merre këshillat e vjera të zotit Ibrahim Ağcagül, që është pra mik i hershëm i shqiptarëve.

Por udha dhe memorja ime, në një distancë parapeti nga jeta në këtë zonë, bashkëjetojnë në një dimension tjetër të ngjashëm e pikëtakues. Ka një muzg të gjelbër, pak para përditësit të diellit, dhe është e qetë si një kapsulë pa sezon. Një pikturë e gjallë me ngjyra vaji të përhershme dhe të trasha. Dëgjoj zhurmat e qytetit dhe në të njëjtën kohë lëviz në heshtje totale, gjithëpërfshirëse. E di që jam në siluetën e një kohe tjetër, dhe kështu ndjej të rikujtoj se në këtë kohë ka më shumë vlerë bashkëpunimi dhe rizgimi i vlerave. Vetëm këto na shpien diku qartë aty rreth pikëtakimeve të fjalës së urtë e të domosdoshme.



SHUMËGJUHËSIA DHE INTEGRITETI KULTUROR

Le ta themi që në fillim, në këtë rast vlerat e lidhjeve internetike ndihmojnë jo vetëm një komunitet, por një tërësi komunitare, dhe këtë mjaft mirë e bën inxhinieri Gëzim Ethem. Është e vërtetë dhe mjaft e njohur se bota po globalizohet dhe po fshihen kufijtë, sidomos në kuptimin e kufijve informativ. Nuk ka më perde hekuri dhe qasja në bazën e të dhënave botërore është e hapur për të gjithë falë internetit dhe burimeve të tjera të informacionit. Sot gjuha është mjet komunikimi dhe në planin e mësimi luan edhe rolin e lëndës së mësimi, edhe si mjetin e plotësimit të detyrave mësimore.

Shumë në ditët e sotme po shtyjnë tezën se koncepti gjuhë e huaj duhet të zëvendësohet me termin gjuhë botërore, pasi ai nuk pasqyron më në mënyrë adekuate gjendjen aktuale të punëve. Sipas përkrahësve të kësaj pikëpamjeje, shumica

e gjuhëve nuk mund të konsiderohen si të huaja, në kuptimin e të qenit krejtësisht të panjohura për marrësit, për faktin se të gjithë jemi vazhdimisht në kontakt me përfaqësues dhe fakte civilizuese që lidhen me kulturat e tjera kombëtare. , si dhe me gjuhë të popujve të tjerë, që jo vetëm të kemi një ide për to, por të ketë një depërtim të ndërsjellë fjalësh, termash, si dhe dukurish të caktuara kulturore.

Gjuhët në shoqërinë moderne nuk ndajnë, por ndihmojnë në bashkimin e njerëzve, ato ndihmojnë në arritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe integritetit kulturor midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme etnike, veçanërisht midis komuniteteve shumëgjuhëshe. Shumëgjuhësia dhe integriteti kulturor do të ishin të pamundura pa arritjet e teknologjisë së informacionit,

internetit dhe të gjitha mjeteve të tjera të komunikimit përmes të cilave bëhet shkëmbimi kulturor dhe informativ në botë, si dhe pa metoda moderne të mësimdhënies dhe mësimi të gjuhëve të huaja.

Në këtë pikë një rol të rëndësishëm luan për komunitetin shqiptar edhe afrimi i mundësive të lidhjeve internetike të kanaleve televizive shumëgjuhëshe. Pse kanë rëndësi këto kanale. Të gjithë largojnë stresin dhe afrojnë mundësi kur luhen ndeshje futbolli. Klienti mund ti siko ato drejtpërdrejt dhe pse gjuhët ndoshta nuk e japin njëqind për qind, funksionin e jep loja dhe mirëkuptimi me sportin. Sporti ka gjuhën e vetë globale, dhe kjo mbetet primare. Kjo përforcohet kur dihet se Televizioni në Mbretërinë e Bashkuar është klasifikuar si shërbim publik për një kohë të gjatë që nga fillimi i tij dhe i nënshtrohet një

rregullimi të veçantë.

Arsyet për këtë janë: kufizimi i spektrit të radiofrekuencave, kostot e larta të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së një rrjeti përsëritës (më të larta se të ardhurat e pritura nga reklamat), numri relativisht i vogël i marrësve dhe supozimi se media elektronike është vetëm si informative dhe kulturore. Institucionet arsimore me ndikim të madh në zhvillimin e vlerave qytetare duhet t'i shërbejnë shoqërisë në tërësi, jo organizmave të caktuara, apo interesave të thjeshta. Kështu, ajo është formuar si një institucion specifik që dominon procesin e trajtuar. Ndaj ta konkludojmë këtë rast se vlerat e lidhjeve internetike ndihmojnë jo vetëm një komunitet, por një tërësi komunitare, dhe këtë mjaft mirë e bën inxhinieri Gëzim Ethem.



MINUSH M. HOXHA I KA BËRË DETYRAT ME “TI, S’I KE BËRË DETYRAT”

Parashtjellim

Para pak ditësh, vetëm pak ditë më parë, “Ti, s’i ke bërë detyrat” (Pejë, 2024) hyri në bibliotekën personale të avokatit krijues, Minush M. Hoxha. Hyri bashkë me shkrime të tjera publicistike, eseistike dhe pjesëza ditari me një kopertinë gri, ku korniza në mes i përket një fotografie me shumë memorje në krah të saj. Fotografia në qendër nuk e vë në diskutim prezencën në zyrën e punës, natyrisht nuk e mendon ndryshe autorin e këtyre memorjeve dhe nuk e shpie diskursin në hapësirë ndryshe, sikurse titulli. As zhvendosjet përbërëse të memorjeve në muret që fikson fotografia nuk e shpërndajnë memorjen gjatë. E gjitha është një. Është gjuhë. Është vlerë. Është kujtesë. Është shpërndarje kohore. Është udhëtim. Është jetë. Është një dhe vetëm një e vërtetë: “Ti, s’i ke bërë detyrat”. Pra, ku qëndron metafora në përbërje të gjithë kësaj estetike funksionale?

Shtjellim estetik

Në letërsi, funksioni estetik është përfshirja e elementeve, ose shprehjeve artistike në një tekst dhe në një konfigurim diskursiv, që krijon art. Mund të quhet edhe funksioni poetik i gjuhës, i cili fokusohet në mesazhin dhe mënyrën se si komunikohet më tërësisht funksionale, dhë po meatë të paraqitjes estetike. Në këtë kontekst ajo që vjen në brendësi është jo thjesht leximi dhe botimi i kahershëm, i njëpasnjëshëm tek “Fjala e Lirë” dhe “Albanian Post” në Londër, por dhe si një diskurs më vete për të treguar, se estetikja e autorit Minush M. Hoxha, është e lirë sikurse funksioni estetik që lejon dhe i bën autorët që të mund të përdorin koncepte estetike për të forcuar qëllimin e tyre të shkrimit, ose për të ndarë mendimet dhe opinionet e tyre

mbi estetikën.

Por sikurse kemi lexuar, e kemi ndjekur tashmë në vite, që nga komunikimi i parë i largët me romanin tim “Blirët e Pejës” dhe jo vetëm kaq, me shkrimet, komentet, krijimet, poetikën dhe narrativin e tij tërheqës, kemi parë se ai formon dhe thelbin e një estetike në krijimtarinë e tij të thjeshtë, por shumë domethënëse letrare, pasi ai ka njohuri në disa gjuhë, ka efektivitet racional njohjeje të kulturave letrare dhe më tej juridike. Në këtë kontekst estetika, në letërsinë dhe krijimtarinë e autorit nga Peja, është përfshirja e referencave ndaj elementeve, ose shprehjeve artistike brenda kësaj vepre tekstuale, sikurse është “Ti, s’i ke bërë detyrat”. Është një metodë e përdorur për të promovuar, ose edukuar lexuesit rreth shprehjes së rëndësishme artistike në shoqëri që krijon memorja funksionale e tërësisë diskursive dhe këtë autori në fjalë e bën shumë bukur në këtë përmbledhje, por dhe në qëmtimet e tij të mëparshme tek lexuesi që e ka përcjellur më kërshëri në vite.

Midis fomave letrare

Midis këtyre formateve të përparuara të shkrimit, krijimit dhe leximit, Minush M. Hoxha, që ka natyrshëm një pjekuri të lartë njohurish, e mirëqet formatin e njohur se estetika është studimi filozofik i së bukurës, i asaj të bukure që qëndron në vetë formatin e të shkruarit të tij, që heraherës kapërcen ndonjë risk, dhe heraherës hyn në një aradhtë me emra të njohur. E pra, pra..., rrëshqitja e ndonjë lapsusi, apo ndonjë nevojë korrektuese, tingëllon mirë apo keq, kjo nuk është ndoshta shumë e rëndësishme për të krijuar mesazhin estetik, sepse në një formë e në një tjetër autori me vetë angazhimin. Etij juridik, artistik dhe funksional i bën dytësore të tjerat. A është proza e

këti autori poetike apo jo, sikurse retorika ndjek shumë kureshtje kreative?

Minush M. Hoxha, sikurse Nabokov shkruan një gjuhë shumë të ndjeshme, prekëse, mjaft sensuale. Nëse do ta lexoni “Ti, s’i ke bërë detyrat” dhe më pas do të lexoni, për shembull, diçka si e folura dhe memorja e autorit që cituam paralelisht, natyrisht do të na mirëkuptoni në këtë pikë. Por kemi ndryshime në shije. Shijet janë si puna e supës në tryezë. Përshembull, Dostojevski nuk duket se është i interesuar për atë tas supë, ndërsa librat e DH Laërence janë të mbushura me detaje të imta, pothuajse impresioniste, po aq mund të them se edhe Henry Miller nuk është, ndërsa shkrimi i autorit Minush M. Hoxha është midis, pra një rrokës i disa shtresave estetike, të cilat e bëjnë një supë të mirë në një tryezë të shtruar nga forma estetike, dhe moderne e të shkruarit.

Tiparet

E themi këtë se nga leximi i kahershëm dhe nga mënyra e njohurive shprehëse në krijimtarinë e tij, sikurse dhe tek prurja e re, Minush M. Hoxha nuk e vë në dyshim thelbësoren se çfarë nënkuptojnë tiparet stilistike dhe formale në letërsi. “Ti, s’i ke bërë detyrat” është në një udhë të mbarë me rrugën në letërsi dhe shkrim, pasi elementet stilistike janë përdorimi i cilësdo prej teknikave të ndryshme për t’i dhënë një kuptim, ide ose ndjenjë ndihmëse fjalës, ose të shkruarit të këtij libri me mjaft interes. Autori në këtë libër përfshin forma dhe teknika ngjashmërie, metafore, sinekdokë (dhe kjo ndodh tek “Ti, s’i ke bërë detyrat” kur një pjesë e një diçkaje përdoret për t’iu referuar së tërës), por autori jo pak herë ndalet tek ky libër edhe tek personaifikimi, karaktonimi (kjo është kur emri i një personazhi tek “Ti,



s’i ke bërë detyrat” ka një kuptim simbolik), po aq dhe tek alegoria, imazhet dhe shumë të tjera.

Struktura

Struktura formale e librit të autorit Minush M. Hoxha, pra struktura formale e “Ti, s’i ke bërë detyrat” i referohet formave të një teksti të plotë, që edhe pse me një gjuhë të thjeshtë, na shpie në një moderim njohurish. Në radhë të parë, një tekst i tillë është i mirëpritur në shtratin e letërsisë. Sidoqoftë, ky tekst, edhe për arsye të vetë terminologjisë dhe formës strukturore mund t’i referohet gjithashtu edhe atyre që bëhen përcaktuese dhe didaktike si nga përkatësia e gjatësisë së rreshtave, strofave ose kantove në poezi, si dhe fjalive, paragrafëve, ose kapitujve në libër. Për më tepër, struktura të tilla të dukshme si dialogu kundrejt narracionit konsiderohen gjithashtu tek ky libër si pjesë e strukturës formale. Autori tek libri i tij më i ri përfshin edhe historinë dhe komplotin, edhe strukturën e komplotit, edhe kthimin në prapavijë, edhe nëntekstin, edhe parathënien, edhe aluzionin, por dhe vetë dhe historinë e kornizës, jo thjesht të asaj kornize që detajon që në kopertinë të librit, por të vetë kornizës ku shpërqëndrohet dhe shtjellohet memorja e autorit.

Restoranti I SHQIPTAREVE

Restaurant Bar "Imperial"

46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

"Shijoni shijet e pjatave tona të shkëlqyera, ku çdo
kafshatë tregon një histori të shijshme."



Kualitet

Dasma

Ne ju ndihmojmë në
perfeksion



Cilësi

Festime

Ju a bëjmë më festive
festën tuaj



Pastërti

Familjare

Ne jemi si një familje
ndaj e dimë
familjaren

Rezervo



020 7624 1385

EDUART BALA: PROFESIONALIZMI PËR DËRGESAT TUAJA

Ju njoftojmë se kompania që drejtohet nga Mondì, që është dhe mbetet kompania më e sigurtë dhe më profesionale e transportit të mallrave nga Anglia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas, do të kryejë destinacionin e saj përkatës të radhës duke grumbulluar mallrat në datën 26 tetor 2023 në këto qytete britanike: Birmingham, Luton, Banbury, Oxford, Coventry, Northampton, Manchester, Leeds, Sheffield. Po ashtu ju njoftojmë se nisja e destinacionit përkatës nga Shqipëria drejt Anglisë bëhet në datën 5 Nëntor 2023. Për më shumë informacion kontaktoni drejtuesit e kësaj kompanie në celularin që jepet në fund të këtij shkrimi.

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania që drejtohet nga Eduard Bala (Mondì) mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti i destinuar mbetet prioriteti dhe profesionalizmi, besimi dhe konsiderata efikase.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdeun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të

eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet

standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë kjo është zgjedhja e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me këtë transport, e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Duhet theksuar se mbi 50kg i marrin dhe i dërgojnë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet



SHPEJT
SAKTË - RESPEKT

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

- **ANGLI:**
- +447395287400
- **SHQIPËRI:**
- +355 68 3676859

VLERA PROFESIONALE

SAKTËSI - KURSIM

RESPEKTI NDAJ KLIENTIT
NA PROVONI



Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

investorë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga

konkurrese dhe në çmime.

Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e

TRANSPORT MALLRASH:
ANGLI-SHQIPËRI &
SHQIPËRI-ANGLI

ANGLI: +447395287400

SHQIPËRI: +355 68 3676859

ROLI I POEZISË DHE REFLEKTIMI I NDJENJAVE NË POEZINË E EMINE S. HOTI

Emine S. Hoti është një poete që hyri në jetën e saj letrare në kushtet e të qenit larg tokës që e lindi, larg dashurisë së saj të ndarë në copa dhe dhimbje, larg dheut që e mbajti sitën e lotëve të familjes së saj të përndjekur nga okupatori serb i Kosovës. Ajo krijoi dhe mori penën të shkruaj me ndjenjë, me atë ndjenjë që kishte në gjak, me atë ndjenjë të ushqyer që trazohej me simbolikën e rrjedhës së gjakut shqiptar dhe i shërbeu poezisë së krijuar nga një shtresë e tillë femërore për rreth tre dekada. Përveçse është një poete që ia kushtoi jetën shkrimit të poezisë, ajo i dha jetë e shërbime shtypit, kulturës, mediave të ndryshme dhe mbajtjes gjallë të traditave si në të shkruar dhe përvijuar të legjendave dhe po aq dhe në traditën folk-artistike me kostumet që i ktheu gjithnjë në një simbolikë atdhedashurie mes artit.

Emine S. Hoti ka lindur në Vushtri, Kosovë, më 20 shkurt 1959. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare. Gjyshi i Eminesë, Selman Hoti, ishte nga Likovci i Drenicës. Ai ishte njeri me emër në fshat e krahinë, si dhe shumë i njohur si pajtimtar gjaqesh. Selman Hoti kishte vëlla Istref Hotin, që ishte komandant i çetës së 12 - të të Shaban Polluzhës, i plagosur disa herë në luftime. Istrefi ishte i dënuar nga regjimi serb me 101 vjet burgim të përjetshëm, por mundi të arratisesh në Shqipëri, në Berat.

Familja e Eminesë ka qenë e përndjekur nga regjimi serb. Fëmijërinë e hershme Emineja e kaloi në Vushtri, deri në moshën 6 vjeç. Më pas u kthye sërisht në vendlindjen e babait në fshatin Çikatovë e vjetër, komuna e Drenasit. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i kreu në Çikatovë të vjetër, si dhe në shkollën "Rilindja" në Dobroshevc (Dritan). Në vazhdim, kreu Akademinë

Pedagogjike në Prishtinë.

Në vitin 1989, së bashku me familjen, mërgoi në Norvegji. Punoi edukatore dhe asistente me fëmijët norvegjezë e shqiptarë nga moshë 3 – 6 vjeç. Në 20 vitet e fundit punoi me fëmijët nga klasa I - IV, edukatore asistente dhe mësuese. Në Norvegji Emineja kontribuoi gjithashtu edhe në mbajtjen gjallë të traditave dhe të kulturës shqiptare, ndërkohë që me pasionin e saj dhe aftësitë si një stiliste e talentuar ajo ka ndikuar shumë në përhapjen e veshjeve tradicionale shqiptare jo vetëm në Norvegji, por edhe në vende të tjera të botës.

Emineja është anëtare e Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë "Papa Kelmendi XI, Albani" Suedi. Midis të tjerave ajo ka botuar librat: "Jetë ferri" (roman), Prishtinë, 2014; "Shqetësime mërgimtarësh" (ese), Prishtinë, 2015; "Hija e heshtjes" (poezi), Prishtinë, 2016; "Poezitë e nënës" (poezi), Borås-Suedi, 2017; "Lulet e vendit tim" (poezi për fëmijë), "Erik Hans", Borås-Suedi, 2018; "Pyeshni zemrën!" (poezi), Tiranë, 2018; "Feniks" (poezi), Tiranë, 2019; "Simfonitë e jetës" (poezi), Tiranë, 2019; "Të gjithë fëmijët janë engjëj" (Poezi), Tiranë, 2020; "Udhëtimet e mia në Shqipërinë Mëmë" (Prozë); "Dardania ime" (Prozë), "Erik Hans", Borås-Suedi, 2021), "Trojet tona janë trupi ynë" (Prozë, Tiranë, 2021), "Të parin kemi atdheun" (Poezi) 2022. "Legjenda shqiptare", (Prozë, Ëest Print 2023) dhe vëllimin "Ecë dhe mos ndalo!" (Poezi, Ëest Print, Tiranë, 2024).

Për jetën dhe veprën e



Emine S. Hotit nga shkrimtari shqiptar V. Kona janë shkruar librat: "Marigoja shqiptare në Norvegji" (Monografi, "Migjeni", Suedi, 2019) dhe "Një ditë me Marigonë" (Prozë, Tiranë, 2020).

Në formimin e poezisë së Emine S. Hoti ndikuan poezitë, rrëfenjat, tregimet dhe fabulat e legjendat, që dëgjoi nga nëna, të afërmit, dhe më së shumti nga prindërit dhe të tjerët në fëmijëri, duke lexuar më pas poetë të njohur nga letërsia, poetë të ndaluar dhe natyrshëm dhe rrjedhën e vetë poetike me të cilën u vetëdashurua që e re. Emine S. Hoti shkroi poezi duke i marrë këta elementë dhe poetë si model dhe krijoi një kuptim sui generis të poezisë së saj jo vetëm në Norvegji, por dhe në disa festivale poetike në Suedi e më gjerë. Periudha kur Emine S. Hoti filloi të shkruante poezi përkon me vitet kur

dashuria e saj dhe vlerat e ndjenjave të tilla kishin prekur lotë, dhimbje dhe natyrshëm dhe durimin e një nëne patriote, e një nëne të lindur dhe ushqyer nga patriotizmi. Poezitë e saj patriotike dhe heroike janë në përputhje me dëshirat e që gjeneruan talentin dhe vulltin e botimit. Pas Luftës së Kosovës në këtë aspektualitet vërehet një ndryshim dhe zhvillim në poezitë e saj në formë dhe përmbajtje. Elementi kryesor në poezitë e Emine S. Hoti është shqiptarizmi, prindi, nëna dhe babai, fëmijët, njeriu. Ajo zgjodhi gratë si frymëzim dhe u bë një interpretese e tyre, duke shtuar

dhe dashurinë mëdhetare dhe ndjenjat e patriotizmit tek brezat. Gratë që e njohin dhe miqtë që e ndjekin, gra patriote, gra të arsimuara të çliruara nga presioni familjar dhe shoqëror, nuse të cilave u vdiqën burrat në luftë, nëna që humbën djemtë e tyre në luftë, vajza që shikojnë rugën e të fejuarit e tyre në ballë janë tipat e grave që Emine S. Hoti përfshin në poezitë e saj. Dhe kjo është një pikë mjaft e domosdoshme e kësaj krijuese artiste, që përkon me kohën e sotme të globalizmit të gjërave dhe humbjes së traditave. Në epokën e sotme të globalizimit, gjithnjë e më shumë krijimtaria, dhe traditat, aq më shumë dhe poezia e grave në emigrim po po lihen pas dore, ndërsa në disa raste edhe pse shkruhet për ta duhet më shumë frymë... (vijon në faqen 13)

(vijon nga faqja 12) ...nga Atdheu dhe nga organizmat që përfaqësojnë kulturën si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut apo dhe në trojet e tjera etnike ku banojnë shqiptarët dhe që kanë të drejtën e tyre shtetformuese dhe shtetpjesëmarrëse. Kur kjo është veçanërisht një temë e preferuar në letërsinë botërore, dhe mjaft kombe i kushtojnë një rëndësi të madhe, në rastin konkret ajo duartrokitet në mjedise e festivale jashtë vendit dhe heshtet nga zyrat në Kosovë e në Shqipëri. Por në një rast tjetër kur një poezi shkruhet jashtë atdheut, dhe kur ndodh që të përkthehet ka dhe ajo një problematikë, natyrisht dhe një kosto të madhe.

Duke ditur se për të shkruar një poezi të mirë përdoren shumë mjete, ndër to është i zakonshëm përdorimi i aludimeve. Një përkthyes që shqyrton një tekst me synimin për ta përkthyer, do të ketë

një sërë shqetësimesh. Midis tyre, aludimet ka të ngjarë të bëhen enigma kur kalojnë një ndarje kulturore. Përkthimi i aludimeve mund të jetë një detyrë kërkuese për faktin se ato aktivizojnë njëkohësisht dy tekste dhe kanë kuptime specifike në kulturën dhe gjuhën në të cilën lindin, por jo domosdoshmërisht në të tjerët, ndaj ndonjëherë gjuha dhe fakti i tillë e sjellin duartrokitjet të bëhet një dilemë më vete. Dhe kjo është pengesa kryesore në të kuptuarit dhe njohjen e kontekstit të situatës së paraqitur në një pjesë të caktuar poezie. Për shembull, poezia e lexuar nga autorja në fjalë në Boras të Suedisë u gjallërua nga duartrokitjet e të pranishmëve dhe tregoi me zërin artistik të vetë autores se është e mbushur me shumë fjalë zemre, fjalor shpirti ose tingëllima të shtrenjta patriotizmi e edukate të thellë. Mund të ketë disa fjalë të zakoneve dhe konventave

lokale të kulturës së vjetër ose bashkëkohore shqiptare dhe ato bëhen të vështira për një lexues suedez, por pesha e duartrokitjeve e tregon se Emine S. Hoti është një art më vete, jo vetëm në një sallë konkurrimi, por dhe në një mjedis të madh ku sytë ndjekin koloritin dhe pasionin. Esaj në shkëmbimin e traditave.


Në mënyrë të ngjashme, poezia e saj ka një thesar të madh të kulturave dhe mitologjisë dhe po aq të legjendave dhe ndonjëherë mund të ketë referenca nga shumë gjetje të saj që sikurse i cituam i ka nga rrjedha patriotike familjare. Dhe të gjitha këto gjëra bëhen të panjohura për personin që i përket botës tjetër, nëse nuk do të kemi gjithnjë një Emine S. Hoti. Megjithatë, përdorimi i shumë ndjesive, dhe kur i ndërthurret aludimeve tregon një pritje që lexuesi të njihet me referencat e bëra, përndryshe efekti humbet, ose nëse Emine S. Hoti nuk improvizon djepin, fëmijën në djep dhe ninullën që ajo e realizon, atëherë do të duhet kohë dhe sqarim më i thellë.

Abrams e përkufizon aluzionin si: "Një referencë kalimtare, pa identifikim të qartë, për një person, vend ose ngjarje letrare ose historike ose për një vepër ose pasazh tjetër letrar." Aludimi mund t'i atribuohet si një nga figurat më të fuqishme të të folurit pasi mund t'i referohet një teksti të jashtëm, sikurse bën mrekullisht Emine S. Hoti me tërë atë pasuri të bollshme tradite dhe kulture që mbart kudo që shkon në konkurrenca dhe festivale. Prandaj, ajo dhe talenti i saj janë një burim i pasur kuptimi dhe konotacioni dhe mund t'i shtohet pasurisë kuptimore të një teksti që shkruan në libra të tillë si "Feniks"; "Të gjithë fëmijët janë ëngjëj"; "Ec e mos ndalo"; "Të parin kemi atdheun"; "Simfonitë e jetës"; "Pyeshni zemrën"

"Trojet tona"; "Udhëtimet e mia në Shqipërinë mëmë"; "Dardania ime"; "Zemra të bukura"; "Legjenda dhe figura të shquara shqiptare"

etj. Kështu në një mori të tillë kreative, në një masë të madhe e të jashtëzakonshme angazhimi didaktik dhe kulturor, ajo që e bën aludimin është vetëm një maskë kërkuese në gjëra më të ndjeshme. Një term që përdoret për të përshkruar aludimin është 'gungë kulturore', të cilën Leppihalme e përcakton si më poshtë: "Përplasja e kulturës ndodh kur një individ e gjen veten në situatë të ndryshme, të çuditshme, ose kur ndërvepron me persona të një kulture të ndryshme". Por këtë Emine S. Hoti, ose ashtu sikurse e ka cilësuar poeti dhe shkrimtari, studiuesi dhe publicisti i mirënjohur, Viron Kona, pra Marigoja shqiptare e Norvegjisë e thuk me pasion, art, kreativitet, pasuri shpirtërore, logjikë, filozofi të ndjeshme, trashëgimi dhe vlerë.

Unë dua të theksoj hapur, se pashë nga afër në Boras, pasi e ndoqa emocionin e duartrokitjeve të të huajve për të, pasi e lexova veprën e saj voluminoze në poezi dhe prozë, dhe pasi rilexova atë që ka shkruar Viron Kona, natyrisht dua të shtoj se poezia e kësaj poeteje të thjeshtë e të kuptueshme duhet të të quhet vera e mendjeve të dëshiruara për të dhe është një verë e tillë e depërtuar në gjakun e njeriut të dashuruar me vlerën. Ajo me poezinë e saj, me përkushtimin e saj dhe me artin e kulturën e veçantë jep një botë paralele e cila është më simpatike dhe joshëse se bota reale në të cilën jetojmë. Me këtë risi, poezia e saj i ka kaluar kufijtë e rajoneve dhe ka hyrë në trojet e huaja me dy krahë më shumë, se ata krahë që i qartëson gjithnjë ajo me Flamurin shqiptar, dhe me veshjet që kanë në thelb këtë simbolikë. Emigranti, salla e mbushur me poetë të ardhur nga troje të ndryshme, populli poetik vendas në Suedi e në Norvegji me këtë sy rrëfen se nuk është i interesuar vetëm për poezinë e huaj, por ka edhe krahasime me mjete të ndryshme vlerë për këtë prurje të sinqertë të Marigos shqiptare në Norvegji...



ARSYET E KËSAJ KËRKESË TË RE KOMUNITARE

Jo më kot OKB citon se natyrisht, këta njerëz duan të kenë akses në lajmet nga shtëpia. Atëherë ja pse mbetet e rëndësishme dora profesionale e inxhinierit tashmë me emër në komunitetin tonë, Gëzim Ethem? Kjo është pjesa e dytë e postimeve rreth kanaleve televizive, programeve, që kënaqin komunitetin shqiptar, dhe që e marrin shërbimin adekuat, në lidhje me programet televizive etnike sipas shpërndarjes së përmbajtjes së tyre profesionale në mjedisin ku ata janë aktualisht të vendosur. Duhet thënë hapur se në një pjesë të parë ne shqyrtuam kërkesën në rritje për programe televizive etnike dhe me përmbajtje të kënaqshme.

Nuk ka pasur kurrë një kohë më të mirë se tani për të shpërndarë përmbajtje pozitive, kulturore, masive turistike dhe qasje tradicionale etnike në të gjithë hapësirën ku janë vendosur shqiptarët. Dhe kjo falë nga profesionalizmi dhe aftësia profesionale e inxhinierit të komunitetit shqiptar, Gëzim Ethem, që qëndron thajse njëzetë e katër orë në dispozicion të klientëve të

tij dhe po aq dhe në dobi të ndonjë defekti, apo lidhjeje që nënshkruhet në sistemin paraparak si vonesë sinjali.

Duke ditur se tashmë po rritet brezi i tretë i shqiptarëve në BM, dhe prindërit e brezit të dytë në veçanti, po bëjnë që kanalet programet televizive etnike të jenë shumë të kërkuara me platforma të ndryshme për bebat që fillojnë që në moshë të vogël të dëgjojnë e praktikohen me gjuhën shqipe, dhe të tjerët të mësojnë e mbesin në komunikim me gjuhën amtare të prindërve të tyre, domosdoshmëria natyrisht rritet. Është vetëm fillimi i një epoke të lulëzimit të shpërndarjes së përmbajtjes etnike dhe këtë më mirë se inxhinier Gëzim Ethem kush mund ta bënte. Këtu janë arsyet e kësaj kërkesë të re për përmbajtje tradicionale, kulturore, etnike dhe kanale televizive me qasje pozitiviteti ...

Ndaj, jo më kot OKB citon se natyrisht, këta njerëz duan të kenë akses në lajmet nga shtëpia, duan të mbajnë ende kontakte me kulturën e tyre të origjinës dhe ndoshta gjithashtu duan t'i ekspozojnë fëmijët e tyre me rrënjët

e tyre, edhe nëse ky është tashmë brezi i dytë ose i tretë i emigrantëve. Kapaciteti mbetet zakonisht një përkushtim në këto sisteme. U zgjodhën përmbajtje që u transmetua me shumë kujdes për të maksimizuar ndikimin. Ndikimi u përcaktua duke arritur audiencën më tërheqëse, qoftë në aspektin e shtrirjes së gjerë (që do të thotë një demografi shumë e madhe për të dhënë) ose potencial të madh (që do të thotë një audiencë që është e gatshme për akses në përmbajtje: sportive, filma të suksesshëm, etj.). avancimi i teknologjisë në aspektin e shpërndarjes ndihmon mjaft.

Shpërndarja e përmbajtjes etnike provon të jetë në rritje si për platformat e shpërndarjes ashtu edhe për ofruesit e kanaleve/ përmbajtjes. Zakonisht, kanali i përmbajtjes / TV ekziston gjithsesi dhe hapja gjeneron



një rrjedhë shtesë. Dhe platformat e shpërndarjes duhet të shmangin dyndjen dhe çdo prerës të kordonit. Krijimi i paketave etnike shpesh i ndihmon ata pikërisht me këtë dhe gjithashtu hap vlera të reja.

Epoka e kanaleve televizive etnike dhe e shpërndarjes së përmbajtjes ka filluar. Ajo do të rritet jashtëzakonisht gjatë vitit të ardhshëm pasi më shumë kanale dhe platforma marrin pjesë në të. Deri më tani, ne trajtojmë vetëm një pjesë. Sigurohuni që tani të jeni edhe ju pjesë e kësaj historie rritjeje.



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



**ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE**

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45



SALMAN ŞIRINGÜL

Arya

SUPERMARKET



Design: www.fjalaelire.com



159-160, Parrock Street, Gravesend,
England, DA12 1ER

NJË DITË NË JETËN E NJË SHOFERI AUTOBUZI NË KOMUNITET

Njihuni me Engjëll Rukaj, një nga drejtuesit e transportit të përgjegjshëm të linjave të autobusëve publikë nga Tunbridge Wells në Spitalin e kësaj zone e më gjerë. Kompania ku punon Rukaj quhet Hams Travel dhe ofron akses, efikasitet dhe përfshirje për komunitete. Në shumë raste kjo linjë ngjan si: “një kryqëzim midis një autobusi dhe një taksie” shprehet një nga udhëtarët në Komunitet. Hams Travel përshtatet me nevojat dhe oraret unike të pasagjerëve, duke ofruar zgjidhje të personalizuar të lëvizshmërisë që kapërcejnë boshllëqet në rrjetin e transportit. Në bisedën tonë me Engjëll Rukaj, ne eksplorojmë ndikimin transformues të transportit që i përgjigjet kërkesës në komunitete, duke theksuar përfitimet dhe sfidat e tij dhe duke ofruar lëvizshmëri, shoqërueshmëri dhe pavarësi më të madhe për përdoruesit e tij.

Çfarë keni bërë para se të vini në Hams Travel?

Kam vite të tëra që jam shofer, përpara se të jem shofer autobusi; para kësaj kam punuar në disa kompani dhe që në moshë të re në vendlindje jeta ime ka qenë e lidhur me këtë profesion.

Çfarë ju bëri të dëshironi të kaloni nga të qenit shofer i thjeshtë në një shofer autobusi për t’iu bashkuar Hams Travel?

Përpara Hams Travel, unë kam qenë shofer agjencie dhe kam bërë punë ad hoc për kompani të tjera dhe nëpërmjet tyre kam qenë gjithë kohës i angazhuar me makinën. Unë isha vërtet rehat me të; kompania ishte e këndshme për të punuar, dhe më pëlqeu. Puna si shofer autobusi në rrugët e shërbimit



mund të bëhet mjaft e përsëritur. Nuk ka shumë larmi ditë pas dite, por aty ndjen më shumë harmoni, ndjen mall duke komunikuar me njerzit pasagjerë dhe miqësohesh me ta. Duke u zhvendosur në Hams Travel, ndjeva se kisha shumë më tepër liri... Natyrisht, ju jeni të lidhur me destinacionet, por mënyra se si arrini atje dhe i kapërceni sfidat e rrugës e bën punën interesante dhe sfiduese. Gjithashtu mund të keni biseda me njerëz, njerëz miqësorë! Unë transportoj të gjitha llojet e njerëzve nga të gjitha sferat e jetës. Dhe ata tashmë pas shumë vitesh kur hyjnë në autobuzin e Hams Travel më thonë “Përsëritet” në shqip dhe po në shqip “Faleminderit!”

Çfarë keni fituar nga puna juaj si shofer në MB?

Njohuritë e mia gjeografike janë rritur vërtet. Mendova se e njihja zonën më parë, por rezultoni se nuk e dija, tani kam zbuluar të gjitha llojet e gjërave që nuk e dija se ekzistonin! Puna ime e mëparshme mund të jetë mjaft e vetmuar dhe dëshpëruese, por me këtë punë ndihem sikur të gjitha

aftësitë e mia sociale janë kthyer dhe mezi pres të shkoj në punë çdo ditë.

Ç f a r ë përfshinte roli, çfarë ishit duke bërë çdo ditë?

OK, kështu që mbërrija në mëngjes dhe më jepeshin disa çelësa, merrja makinën time të biletave dhe PDA-në time. Më pas do të

dal, do të gjej autobusin tim, do të bëj të gjitha kontrollet e mia, sigurohem që çdo gjë të jetë në rregull dhe automjeti të jetë i sigurt për të vozitur. Më pas do të ndiqja PDA-në, e cila do të më çojë në marrje dhe zbritje të ndryshme gjatë gjithë ditës. Ishte si një kryqëzim mes një autobusi dhe një taksie puna ime e mëparshme.

Çfarë trajnimi keni pasur për këtë rol? Natyrisht, ju tashmë po drejtonit autobusët...

Unë u trajnova për të përdorur PDA-në, makinën e biletave dhe platformën me aftësi të kufizuara. Më duhej gjithashtu të njihesha me automjetet e ndryshme përpara se të dilja me një shofer në hije.

Çfarë aftësish duhet të keni për të qenë shofer i Hams Travel?

Duhet të keni durim të pafund; ju duhet të jeni vërtet vigjilent ndaj asaj që po ndodh në rrugë dhe rreth jush në autobus dhe jashtë. Duhet të jeni të përgatitur dhe fleksibël.

Çfarë ju pëlqen më shumë në punë?

Më pëlqen të njoh njerëz të rinj, të flas me ta dhe të mësoj gjëra të reja prej tyre. Plus, vozitja më jep lirinë time. Më pëlqen të punoj me ekipin – ata janë të mrekullueshëm. Pasagjerët ndonjëherë mund të jenë paksa sfidues, veçanërisht nëse vraponi më vonë për çfarëdo arsye. Por unë e marr me kujdes - është pjesë e punës.

Çfarë do t’i thoni dikujt që mendon të aplikojë për një punë tek Hams Travel?

Unë do t’u thosha se orët janë mjaft të qarta, është një vend i mrekullueshëm për të punuar dhe një punë e shkëlqyer. Natyrisht, është një shërbim i ri, dhe ne duhet të nxjerrim fjalën atje - t’i japim një shans dhe të ndërmarrim hapin për të punuar këtu.

Engjëll Rukaj është një shofer që punon në shërbimin Hams Travel, duke i shërbyer komunitetit me transport të përgjegjshëm ndaj kërkesës në të gjithë zonën e Tunbridge Wells. Një tarifë e vetme për çdo gjatësi udhëtimi brenda zonës operative është 2 £ për një të rritur dhe 1 £ për fëmijë dhe udhëtimet janë korrekte. Shërbimi është i disponueshëm sipas platformës dhe tabelave të orareve. Por ajo që duhet shtuar se jo vetëm atë e respektojnë të gjithë, por dhe kompania Hams Travel e ka vlerësuar dhe dekoruar disa herë për punë të mirë, sjellje shembullore, korrektësi dhe profesionalizëm. Ai jeton dhe punon me familjen e tij në Hastings. E shoqja e tij është mësuese kompjuteri dhe fëmijët, djalin dhe vajzat i ka në shkollë e kualifikim e sipër.

NJË DITËLINDJE NDRYSHE PËR ZONJËN HAVE CUFAJ

Sonte në familjen Cufaj, në Sektorin "Rinia" Durrës do të festohet 69 vjetori i zonjës së shtëpisë. Zonja Have që lindi shtatë fëmijë, por që njërin, Elmiun e humbi në një aksident tragjik në moshën 16 vjeçare, sonte do të largoj lotët dhe do të ngrej dolli me të gjithë të dashurit e saj. Edhe i biri i saj, Gazmendi, që herët e tjera i binte të udhëtonte në fundgusht për në Londër, këtë vit do të jetë në tryezën e festës familjare. Natyrshëm dollinë e parë do ta grej i dashuri zemrës së saj, Demushi, me të cilin ndau hallet dhe gjeti forcat për të përballuar një jetë të tërë plotë sakrificë, por dhe Bukurija, Gazmendi, Shkëlqimi, Kujtimja, Edmondi dhe Elona. E kështu në këtë tryezë mes gëzimit të përbashkët për gjashtëdhjetë e nëntë vitet e saj do të jetë kryefjalë jeta, rrugëtimi jetik, familja dhe e sotmja. E djeshmja natyrshëm është një memorje...

Zonja Have lindi në fshatin Sakat të Pukës, dhe në një moshë të ndjeshme rinore, ende pa prekur pragun e duhur rinor, ajo u martua me Demushin në Truhen të Pukës, kur të dy kishin vetën 3 muaj diferencë. 3 muajt e tillë, midis 6 qershorit të Demushit, dhe 3 shtatorit të Haves, më pas i bënë ata jo vetëm bashkëshortë, por dhe binjakë jete të jete plotë sakrificë, përballje dhe situata që vinin nga arsye të cilat lidheshin

me sistemin dhe mospajtimin me atë sistem nga rrënjët e familjes së madhe Cufaj. Dhe më pas dashuria ishte vetëm një shtyllë që i bënte ballë risqeve dhe rrizqeve.

Ajo, si një nënë e re, por si një model më vete, ngrihej që me natë dhe për gati 2 ose tri orë i bënte të gjithë gati. Lante dhe pastronte dhe pastaj pasi i dërgonte fëmijët në shkollë shkonte në frontin e punës në bujqësi. Atje e priste norma dhe disiplina proletare, se ndryshe ai sistem të përndjekurve u bënte namin. Ajo nuk donte që tragjeditë, sikurse ishin dhe në atë sistem të bëheshin monumentale, apo spektakolare tek burrat, sidomos tek burrat e atij fisi. Ndryshe e kishte menduar atë që tragjeditë bënin për burrat në libra. Ishin tragjedi heroike. Dhe tronditëse. Ata janë shkruar, kujtuar dhe festuar. Ceremoniale disi, i krishterë. Epikat frymëzojnë historinë, një muzë këndon atë zemërimin vrasar të Akilit. Një hero i pashëm ballkanik loton si ftua i verdhë në skajin e nënës së tij, ndërsa kali i tij personal e këshillon se si të shpëtojë nga një ndodhi e keqe me një rival. Dhe, ashtu nëpër libra të verdhë, të ndaluar, që gjendeshin në raftet e strukura të fisit Cufaj leximet tregonin, se si Sir Lancelot të ndryshëm joshin Guineverët e mbretërve të ndershmë Arturianë, dhe më pas bien të përtypur në sagat - thashethemet shekullore të

njerëzimit - duke kënduar për bëmat e tyre të padëgjuesha...

Por tragjeditë e grave janë në miniaturë. Dashuritë. Dasma. Fëmijët. Mijëvjeçarë të torturave, që ngjajnë me panoramat zbukuruese, për shkak të heronjve tanë të përfshirë në betejë të përditshme.

- Më në fund, të lexosh diçka, pa pjesëmarrjen e një tragjedie, thjesht për një ditëlindje nënë, një nënë heroinë, që sot feston në lokalin e të birit, Shkëlqimit ditëlindjen e saj të gjashtëdhjetë e nëntë!

Sytë e fëmijëve, nipërve dhe mbesave janë duke pritur e përcjellur fishekzjarre vlerash. Dollitë janë njëra pas tjetrës. Lëndët e ndrojtura të vjeshtës që sapo ka trokitur flasin me të artën flugurues të shpirtit. Fshehurazi nga thellësitë e zemrave të mbledhura bashkërisht, vjeshta gudulis pamjen e bërë prush nga muaji i kaluar gusht. Askush nuk ka dëshirë të flas sot për të shkuarën, për dhimbjet, përndjekjet, hallet dhe problemet. Gjithkush në realitetin e asaj feste familjare kërkon vetëm që dielli të dojë të gjithë. Të gjithë edhe jashtë asaj sale, pasi fisi Cufaj është me atë që do lirinë, që do prosperitetin, që dëshiron demokracinë...

- Shtypi po gjëmon, dhe shoqëria është e ndarë. A po më dëgjon edhe mua? E shkuara, natyrisht, mbetet në anën e errësisrës, por çfarë i mbetet gruas së gjorë që jetoi dhe u sakrifikuara në jetën dhe moshën më të bukur në atë errësi? Sot Zonja Have e ka syrin plotë. I ka të gjithë në festë...në ditëlindjen e saj.



I përqëndruar dhe i gëzuar, Demushi e shikon heshtjen deri në fund, ku qëndrimi qytetar i festës dhe festives bëhet kryefjalë. Dhe në sytë e bashkëshortes së tij sheh, ato ditë kur lotët për dhënien e shkollës, të drejtësisë studimit, Gazmendit, që kishte mbaruar me dhjetë, do të vinin një ditë dhe ai do të shkonte duke sakrifikuar një vit punë në Skënderbegas. Ato lotë sot janë plotë gëzim, janë lotë gëzimi, pasi Gazmendi i sjell vetëm gazmend asaj dhe tërë familjes. Ai është një shok, mik, zotëri, intelektual i zoti dhe mjaft korrekt me shoqërinë. Ai është sot në sytë e nëns së tij por dhe të Demushit, babait të tij të dashur.

Një muzë e tërbuar rreh brenda tij, gati për të gëlltitur tërë rrjedhën në një gotë raki. Atë që ka ndodhur me gruan e asaj kohe, me nënën e tij ai e quan tragjedi, Tragjeditë e grave janë të padukshme. Ata vijnë dhe shkojnë në askund. Kanalizimet e historisë janë të pamëshirshme ndaj tyre. Në heroizmat e tyre, armët nuk shkrepin dhe masakrat nuk e shtrojnë fatin e kolektivit me plagë të përgjakshme. Vetëm një herë në një kohë, një dashuri e madhe mbush derën e lokalit me një buqetë të madhe me lule. Dhe festa ka një kptim më vete, ka një memorje...



GAZMEND CUFAJ BISEDË ME AKTORIN E HUMORIT SHQIPTAR ANDREA VRETO

Aktori i humorit Andrea Vreto ka qenë këto ditë në shoqërinë dhe respektin e përkushtuar të biznesmenit shqiptar dhe drejtuesit të kompanisë "BigBoss Services Uk Ltd", Gazmend Cufaj. Të dy si frekuentues të rregullt të ditëve të gushtit janë takuar tek "3XH-Beach Bar & Fast Food" në Sektorin "Rinia" Durrës, që është në pronësi të biznesmenit tjetër Shkëlqim Cufaj. Ka qenë një kohë e gjatë që Andrea nuk ka qenë në ekranin e televizioneve shqiptare, pasi projektet tek të cilat ai ushtronte janë mbyllur dhe tashmë ai synon që së shpejti të jetë me projekt në teatër. Kështu këtë lajm e kanë mësuar me këtë rast dhe vëllezërit Cufaj, të cilët natyrshëm si klientin e tyre gëzojnë respekt dhe këtë e kanë treguar gjatë frekuentimit të tij, pasi

kanë dalë dhe kanë pozuar bashkë. Andrea Vreto me këtë rast ka folur për karrierën e tij. Fillimet e tij që kanë filluar nga seriali "Fresk Fare" e deri te Klanifornia, sikurse ka rrëfyer do të jenë tashmë më solide dhe së shpejti me projekt në teatër. Aktori i humorit Andrea Vreto, u ka folur miqve të tij dhe për fillimet e tij në karrierën e tij në aktrim, 10 vite më parë. Vreto ka rrëfyer me çiltërsi, respekt reciprok dhe me një gotë në dorë, se nismën e kishte si student i Akademisë së Aktrimit, në serialin "Fiks Fare", pastaj në Apartamentin 2 xl deri te Klanifornia. Fillimet e tij ishin si student në Akademinë e Arteve, dega Aktrim, erdhën në serialin "Fiks Fare", dhe shtysën e ka pasur nga Turjan Hyska, si producent. Më pas ai ka treguar me sinqeritet se këtë ndihmë e ka pasur prej Hyskas, edhe

te spektakli "Apartamenti 2 XL", deri te Klanifornia, ku shtoi se ka ecur shumë mirë me kolegët, dhe ishte mjaft i kënaqur me punën, talentin, përkushtimin dhe me kolegët e tij. Marrdhënia me Turin, është shprehur ai, më ka ndryshuar jetën, më ka ndihmuar në fillimet e mia, në rolet e mia, sepse ne luanin me njeri tjetrin me skenar të papërcaktuar. Ai sikurse njihet normalisht për qetësinë etij, edhe në këtë bisedë të lirë me Gazmend Cufajn, ka treguar se gjatë gjithë këtyre viteve ka arritur të ketë lirshmërinë



me stafin, sepse rruga e aktrimit normalisht që është shumë e vështirë.

Pra, pas përfundimit të spektaklit "Klanifornia", Vreto tha se së shpejti pritet të rikthehet në një projekt në Teatër, me disa shokë për një shfaqje dhe se shfaqja do të jetë shumë e bukur dhe mezi po e pres rikthimin. Si student kam luajtur në shfaqje, dhe besoj se ky projekt i ri do të jetë shumë i mirë. Me këtë rast shoqëria e mirë edhe në këtë bisedë ka bazshkuar dy karakterë fisnikë me njëri tjetrin dhe me një sinqeritet të hapur kanë rrëfyer për projekte, përkushtime dhe për angazhimet e tyre reciproke në të ardhmen, njëri në skenën dhe teatrin e atdheut dhe tjetri në vendin e dytë ku jetoj, punon dhe angazhohet prej disa vitesh bashkë me familjen etij të mrekullueshme.



BASHKË ME NDRYSHIMET LIGJORE DHE FORCIMI I DISIPLINËS NË PROJEKTE

Kompania e drejtuar nga Gazmend Cufaj, "Big Boss services Uk Ltd" është njohur kohët e fundit edhe me vazhdimësitë e procesit të paketës së kontratës së ndërmjetme të ndërtimit. Për këtë kjo kompani, ka theksuar dhe po vendos në zbatim dhe shumë nga ndryshimet e bëra në lidhje me situatat që synojnë të pasqyrojnë praktikat dhe legjislacionin më të fundit të industrisë. Në kontratat e reja, hartimi i punës në bashkëpunim - i cili më parë ishte opsional - tani është një nen i detyrueshëm. Ekzistojnë gjithashtu baza të reja për të kërkuar kohë dhe - nëse zgjidhen si opsion nga palët, si përsëmbull, para për epidemitë dhe ndryshimet në ligj, si dhe dispozita për pagesat e përfundimit dhe dëmet e pagueshme pas përfundimit. Për më tepër, kontratat e reja me të cilat është njohur dhe vazhdon të funksionoj sipas tyre "Big Boss services

Uk Ltd" përfshijnë dispozita që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe dispozita për të mbuluar ndryshimet legjislative, të tilla si Pjesa 2A e Rregulloreve të Ndërtimit 2010 dhe Akti i Falimentimit dhe Qeverisjes së Korporatave 2020. Kontrata e Ndërtimit, e quajtur e pjesës së ndërmjetme me projektin e kontraktorit, e njohur si ICD, ka klauzola të reja të përgjegjësisë së projektimit të cilat përcaktojnë nivelin e aftësive dhe kujdesit të kërkuar në lidhje me pjesën e projektuar nga kontraktori dhe konfirmon se kontraktori nuk do t'i nënshtrohet një 'përshtatshmërie për detyrë e qëllimit. Kjo vazhdimësi e ka bërë këtë kompani të jetë më në korrekt të vlerave, disiplinës, konkretizimit



në kohë dhe cilësisë së punimeve. Sikurse dihet tashmë industria e ndërtimit në Mbretërinë e Bashkuar po kalon një ndryshim transformues dhe mënyra se si i ndërtojmë shtëpitë tona po ndryshon. Standardi i shtëpive të së ardhmes 2025 është në krye të këtij ndryshimi, duke synuar të reduktojë ndjeshëm përdorimin e energjisë dhe emetimet e gazrave serrë në shtëpitë e reja. Ndërsa i afrohemi datës së zbatimit

të vitit 2025, kuptimi i këtyre ndryshimeve është thelbësor për arkitektët, zhvilluesit dhe ndërtuesit. Me këtë moto po shkon drejt standartizimit të ligjit të ri dhe vetë kompania "Big Boss services Uk Ltd". Kjo kompani me anë të drejtuesit dhe stafit të saj ka bërë të njohur edhe cili është ligji i fundit i ndërtimit. Ai është amendamenti më i fundit që ka përfshirë të drejtën e pagesës me këste për kontratat që zgjasin më shumë se 45 ditë. Gjithashtu, kjo kompani thekson se ky amendament, ka bërë disa ndryshime në mekanizmat e pagesës dhe të drejtat e pezullimit të punimeve në rast mospagese. Këto duhen trajtuar dhe përdorur me kujdes, shton z Gazmend Cufa, në fjalën e tij sqaruese.

BIG BOSS SERVICES UK LTD

BUILDING CONTRACTORS

Our services include:

Guttering
Painting
Decorating
Power Clean
Scaffolding
PVC Windows
Loft Conversion

Plastering
Carpentry
Roofing
Brickwork
Tiling
Kitchen Fitting
Extensions
Bathroom Fitting

Thank you so much!

KONSULTIMI me ekspertët është ZGJIDHJA MË E MIRË për ta shmangur humbjen.

Gazmend Cufaj

big_boss_services_uk_ltd

BigBossServicesUKLtd

@BigBossServices

Tel: 020 8591 9198
Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474
Email: bigboss-services@yahoo.co.uk
website: www.bigboss-services.webs.com
UTR: 7168616298
CRN: 8344897
VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës,
Tiranë dhe në
zonën e Plazhit
deri tek Mali i Robit

Kontaktto:
07883029474 dhe 00355685309800

QEMAL VISHA: MATURANTI I PARA 34 VITEVE SOT...

Takimet me ish-maturantët pas shumë vitesh janë emocionale mbi të gjitha. Kanë mall shokësh, kanë nostalgji moshe, vitesh, kanë dhe një përlogaritje arritjesh. Por kanë dhe lotë, dhimbje për shokë që ndahen dhe ikin në amshim. Ish-maturatët nuk janë më ata moshatarë të kohës tjetër, por hyjnë në një privilegj që ua jep risku i piekurisë patjetër.

Me këtë ndjesi u takuan nga mesi i muajit që kaloi dhe maturantët e viteve 1986-90-të të Gjmnazit "28 Nëntorit" në Burrel. Pra, klasa e IV-ërt e vitit shkollor, 1989-90, që ishte dhe viti i fundit i një sistemi, që sapo kishte filluar të jepte frymë, u mbloodh për të kujtuar ato vite nën kujdestarinë e mësuesit Fran Gjoni. Inicialet e mbiemrat e regjistrit shkollor të atij viti, A. Burreli, A. Kadiu, F. Pirra, Y. Fizmoni, Y. Honi, V. Spahiu, F. Gjonaj, Q. Visha, L. Ruci, Buka, A. Hoxholli, L. Bunga, A. Kola, A. Hasula, A. Muça, R. Gjoni, K. Bruka, P. Cerami, A. E'themi, F. Lleshi, Sh. Domi, R. Sula, kishin arsye të tjera të bënin krahasimin, jo vetëm në fotografinë e fiksuar bardhë e zi të asaj kohe, por dhe me vitet e tjera. Pra, midis tyre edhe Qemal Visha, drejtuesi i kompanisë "Alvavisha Ltd" në Londër, natyrshëm ka ndërjerë dhe atë që ndihet më së shumti kur je në emigrim. Matura u takua pas 34 vitesh ndarje nga bankat e shkollës. Dhe ai që nuk i harroi, por që i kujtoi dhe i frymëzoi që të ritakohen profesor Fran Gjoni, natyrisht si organizator mbetet meritori e dollibashi i një tryeze me hare, këngë, gëzim e kujtime të vyera. Për këtë Qemal Visha shprehet: "I përshëndes të gjithë shokët e klasës që morrën pjesë dhe ata që nuk mundën për arsye të ndryshme".

Që në fillim tubuesit kanë përkujtuar shokët e tyre që janë ndarë para kohe nga jeta, Flamur Pirrën dhe Kastriot Brukën. Kështu atë ditë bankat e klasës në shkollën e re, të rikonstruktuar “28 Nëntori” Burrel ndjenë aromën dhe dëgjuan zërat e maturantëve dhe heshtjet e mureve pëshpëritën kujtimet e tyre.

Sot ata mësuhan se shkolla ka rreth 594 nxënës të ndarë në 16 klasa në tre vite përkatëse të gjimnazit dhe nga këta 48 nxënës ne arsimin profesional, dega pedagogjike. Gjithashtu ofron zgjedhje të detyruara në klasa të X-ta, 4 ore, klasat e XI –ta 6 ore. Duke patur mundësi nxënësi te zhvilloje 2 gjuhe te huaja dhe te specializohet per lende te ndryshme. Komuniteti i shkollës përbehet nga prindër kryesisht me arsim te mesëm (74%), gjendja social-ekonomike e tyre është mesatare, ku me shume ne marrëdhënie pune janë prindërit meshkuj. Shkolla ka 594 nxënës. 53% e nxënësve vijnë nga zonat rurale, 25% e nxënësve jetojnë ne familje me ndihme ekonomike, 4% e nxënësve u mungojnë njëri prind, 10% e nxënëse e kane njërin prind në emigracion.

Shkolla synon përmirësimin e rezultateve në PME, duke përdorur metodat të mësimdhënies me ne qendër nxënësit dhe edukimin e tyre si qytetare aktive të një shoqërie që mbështetet në vlerat e demokracisë. Shkolla ka laborator informatike për nxënësit, mësuesit e shkollës si dhe për zhvillimin e trajnimeve të ndryshme nga DA dhe ZA. Shkolla jone ofron në zgjedhje të lira projekte dhe module në klasat e X-ta dhe të XI-ta, ku 6 klasa i kemi të përfshira në projekte kurrikulare në shërbim në



komunitetit. Shkolla jone ka patur fitues te olimpiadave te ndryshme si matematike, kimi, fizike ne shkalle rrethi. Një nga arritjet kryesore te shkollës tone është kalueshmëria 100% e nxënësve nga te cilët 80% kane fituar te drejtën e studimit ne Universitet Publike. Prej tyre 45% ne 3 preferencat e para. Shkolla jone ka arritur te realizoje projekte ne shërbim te komunitetit në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit tone dhe Zyrën arsimore. Këtë vit bashkëpunimi ka arritur në rang ndërkombëtar, ku bashkëpunimin më i ngushtë mbetet me shkollat e mesme te Rumanisë dhe Kroacisë. Këto biseda që u lexuan nga hoistoriku i shkollës, dhe kujtimet e tjera që u sollën

e bënë akoma më të bukur takimin emocional. Natyrshëm biseda e ngrohtë e Profesor Avni Hoxha ishte një monet tjetër. Pjesa tjetër ishte e gjitha në dispozicion të ditës më të përkujtuar të jetës shkollore. Ndaj ajo mbetet mjaft e bukur, emocionuese, jetëdhënëse dhe inspiruese. Prandaj një festë e tillë është një përmasë më vete, për disa çdo diplomim është aq larg sa do të shkojnë. Dikur ka qenë klasa e 8-të, atëherë po të mbaroje shkollën e mesme ishte gati të shkoje në punë. Dikush nga të pranishmit kujton “Unë dhe vëllezërit e mi u larguam të gjithë nga shtëpia dhe filluam jetën menjëherë pas diplomimit. Prindërit tanë kishin mbaruar me rritjen e fëmijëve...



HILAL FOOD CENTRE
KILBURN

SOMBORKAT NGA KOSOVA

EKSKLUZIVE

SPECA TË KUQ NGA FUSHAT
E KOSOVËS



SOMBORKAT NGA
FUSHA



KONTAKTO:
0207 3721 059



ADRESA:
322-324 KILBURN HIGH ROAD



Oferta Ekskluzive
nga Kosova

Telefoni tani

POROSIT:
0044 2073721059



Oferte Exclusive
Specia Somborka

NGA KOSOVA



322-324 Kilburn Road, NW6 2QN

PRE ORDER: +44 2073 721059

NGA FUSHA
TË FRESKËTA
KOSOVARE

Somborka speciale

- Cilësore
- Konkurruese
- Ekskluzive
- Nga fusha
- Prodhim i ri
- Kosova



0044 2073721059

OFERTA SPECIALE

322-324 Kilburn Road, NW6 2QN

HILAL FOOD CENTRE

SUPERMARKETI I SHQIPTARËVE



kualitet - cilësi





 **SUPERMARKET**
I SHQIPTARËVE

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi me produktet,
çmimet, vlerat, cilësinë e
ushqimeve, produkteve, mishit,
vezëve. Konkurren kudo!



Supermarket
PAUZA E RE 2024



Kontakto
02073721059



Email
INFO@HILALFOOD.CO.UK

MIRË SE VINI

